

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Legjislacioni dhe biznesi
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Semestri:	I
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lëndë fokusohet në dispozitat ligjore që janë të ndërlidhura me ndërmarrësin dhe inovacionin, literatura e përdorur përfshinë tema që identifikojnë: Shteti dhe Biznesi, Legjislacioni - burimet juridike që e rregullojnë fushën biznesore, Inteligjenca Artificiale dhe Burimet Juridike, Ndërmarrja dhe rëndësia e saj për ekonominë e vendit, Dispozitat ligjore për ndërmarrësi dhe inovacion, Legjislacioni që e rregullon aktin e themelimit dhe regjistrimit të start-up (dokumentacioni), Parimet ligjore në fushën e aktivitetit biznesor në vend krahasuar me BE, Rëndësia e pronësisë intelektuale për inovacion dhe ndërmarrësi, Ligji për Pronësi Intelektuale në tregun e BE, Inteligjenca Artificiale dhe Legjislacioni në BE, Strategjia për ndërmarrësi dhe inovacion sipas dispozitave ligjore të aplikueshme në vend, Mardhënja e punës dispozita ligjore për të punësuarit dhe punëdhënësin, Legjislacioni për zgjidhje të kontesteve biznesore, Dispozitat ligjore për falimentim të ndërmarrjeve, Legjislacioni për zgjidhjen jashtë-gjyqësore të kontesteve biznesore, Legjislacioni për institucionet mbështetëse për ndërmarrësin dhe inovacionin në vend.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi i modulit është që studentet të zhvillohen si profesionist ligjërës të aftë, të cilët janë në gjendje të aplikojnë aspektet ligjore të përgjegjësive të tyre karshi biznesit me fokus të ndërmarrësisë dhe inovacionit, me synim të arritjes së avantazhit konkurrues në përputhje me vlerat profesionale personale dhe organizative për të krijuar vlerë ekonomike për ndërmarrjen në tregun e synuar. Ky modul do t'i mundësojë studentëve krijimi e aftësive dhe shkathtësive për të qenë kompetent për aplikim të drejtë të akteve juridike që parashihen për biznes - ndërmarrësi dhe inovacion varësisht nga lloji i ndërmarrjes sipas aktit të regjistrimit, duke identifikuar përpirësinë që jepet ligji për Inovacion dhe bartje të dijes teknologjike, si dhe të ligjeve tjera që janë të ndërlidhura me aspektin

	ekonomik.		
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Analizon dhe interpreton legjislacionin e nevojshëm për biznese - ndërmarrësi dhe inovacion, (ECTS: 0.60), 2. Kupton ndikimin e Inteligjencës Artificiale (IA) ne Burimet Juridike biznesore dhe Legjislacionin për IA dhe Treg te BE, (ECTS: 0.40), 3. Dallon aktet normative ndërlidhur me e ndërmarrjen sipas llojit te biznesit, (ECTS: 1), 4. Formulon strategjinë e implementimit te legjislacionit ne fushën biznesore - ndërmarrësi dhe inovacioni, (ECTS: 0.50), 5. Përpilon aktin e themelimit te paraprë me legjislacionin ne fuqi për ndërmarrjen, (ECTS: 0.50), 6. Liston kriteret për hartimin e një kontrate detyrimore ne mese te punëdhënësit dhe punëmarrësit, (ECTS: 1), 7. Identifikon programet dhe strategjitë mbështetëse ne vendin tone për inovacionin ne ndërmarrësi, (ECTS: 1), 8. Ndërton kompetenca për te marre pjese ne pune ekipore për implementim te akteve ligjore qe rregullojnë fushën biznesore - ndërmarrësi dhe inovacion, (ECTS: 1),		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/Ligje	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte	2	5	10
Projekt kursi (planifikim + zbatim)	1	5	5
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			50
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	2	2	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjërata do te organizohet duke pas studentin ne qendër, do te dëgjohet opinionin i studenteve për literaturën qe do te përdoret, për mënyrën e organizimit te ligjëratës e cila do te jete e koordinuar me studentet për diskutime interaktive lidhur me temat e ligjëruara duke mare raste studimi te cilat do te diskutohen ne grup, shqyrtimi i mundësisë për vizitë praktike-grupore me studentë, mësimi duke u bazuar ne një problem te paraqitur, angazhim për studentin për te prezantuar njohurit e fituara gjate ligjëratës dhe prezantimi i projekteve/punimeve te studenteve – si dhe diskutime ndërlidhur me materialin e përpunuar.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e	Metoda e vlerësimit – mbështetet ne tri aktivitete – ne baze të të cilave do te ndërtohet nota përfundimtare:		

kalueshmërisë	➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminari..max 20 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 60 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme: • Aktiviteti në mësim (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryej dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën. Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë. <table border="1" data-bbox="565 1323 1396 1533"> <thead> <tr> <th colspan="2">Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari</th></tr> <tr> <th>Komponenti</th><th>Pikët (%)</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Struktura dhe Qëllimi i punimit</td><td>6</td></tr> <tr> <td>Përmbajtja/shtjellimi i punimit</td><td>8</td></tr> <tr> <td>Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit</td><td>6</td></tr> <tr> <td>Gjithsej:</td><td>20</td></tr> </tbody> </table> Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme, Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit. Testi i provimit mund të organizohet me gojë dhe me shkrim	Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari		Komponenti	Pikët (%)	Struktura dhe Qëllimi i punimit	6	Përmbajtja/shtjellimi i punimit	8	Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	6	Gjithsej:	20
Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari													
Komponenti	Pikët (%)												
Struktura dhe Qëllimi i punimit	6												
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	8												
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	6												
Gjithsej:	20												

	(formulari me pyetje) duhet te plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kritereve dhe përmban: ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....25 pikë (%), ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....35 pikë (%), Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve te mësim–nxënies dhe aftësinë analitike për t’i zbatuar ato në situata praktike qe kërkon tregu i punes. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime/detyra praktike ligjore, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 150 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në ushtrime/detyra praktike. • 105 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara ne modulin e lëndës. • 45 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 4 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 2 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike (shpjegim ligjesh).																												

Literatura	
Literatura bazë	1. Besnik Krasniqi – “Ndërmarrësia dhe Inovacioni”, Prishtinë 2016, 2. Ismail Mehmeti – “Legjislacioni dhe Biznesi”, Ferizaj 2025 (Ligjëratë e autorizuar), 3. Armand Krasniqi – “E Drejta Biznesore Ndërkombëtare”, – Peje, 2015,
Literatura shtesë	1. Joseph A. Schumpeter – “The Theory of Economic Development”, 1st Edition, New York, 2017, 2. Ismail Mehmeti – “Ligjet ne funksion te biznesit”, monografi, Prishtine 2022,
<u>Informacion shtesë</u> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	*Punimi Shkencor - nga autoret: G. Deda, A. Terstena, Sh. Hajdini Gashi, E. Maloku dhe I. Mehmeti, me titull – “Legislation and sustainable economic development – impact on youth employment – focus Kosova”, Prezantuar ne Konferencen Shkencore –“7-th International Black Sea Modern Scientific Research Congress, Artvin, Türkiye”, June 24-26, 2025, Proceeding’s book, page 3, ISBN 979-8-89695-113-1 Linku i punimit: https://www.blackseacountries.org/_files/ugd/614b1f_202ba53eca0348d8bd05666c5e1c7b43.pdf
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Shteti dhe Biznesi, Legjislacioni - burimet juridike qe e rregullojnë fushën biznesore, Është ligjëratë hyrëse, studentët njoftohen me plan-programin e lëndës, diskutohet për detyrat dhe angazhimet përgjatë semestrit për projekt/punimet, fillohet me ligjëratë gjithëpërfshirëse për shtetin, biznesin dhe legjislacionin (burimet juridike) - rëndësia e zbatimit ne fushën biznesore – diskutim me studentet për propozime eventuale qe ata i shohin te arsyeshëm ndërlidhur me lëndën. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e dytë	Inteligjenca Artificiale dhe Burimet Juridike, Bizneset si shoqëri tregtare, Në këtë ligjëratë studentët do te njoftohen me rolin e IA për burimet juridike biznesore, për rolin dhe rëndësinë që e kanë ndërmarrjet ne zhvillimin ekonomik te vendit – llojet e bizneseve, si ndikojnë bizneset e ndryshme ne trendët ekonomike – ato janë financuesi kryesor i buxhetit, punëdhënësit me te mëdhenj ne vende, arteret kryesor ne jetën sociale, diskutim dhe përcaktim i studenteve për propozime për tema, punime seminari, prezantime te ligjit, etj. Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2.
Java e tretë	Raportimi financiar, Dispozitat ligjore për ndërmarrësi dhe inovacion, Gjate ligjëratës do te ketë ushtrime- përsëritje te ligjëratës paraprake, studentet do te njoftohen për rëndësin e raportimit financiar te ndërmarrjeve, për dispozitat ligjore ndërlidhur me inovacionin dhe

	ndërmarrësin dhe procedurat tatimore, me strategjitë e hartuara për zhvillimin e ndërmarrësisë në vend dhe rendësin e zhvillimit të këtij sektori për ekonominë e vendit. do të ketë diskutim grupor për një rast studimi ligjor të ngritur si qështje për trajtim. Rezultati i prituri nr. 2 dhe 3.
Java e katërt	Administrimi i Procedurave tatimore dhe strategjia mbështetëse për ndërmarrësi dhe inovacion, Tema nga punimi shkencor, Gjate ligjëratës do të ketë ushtrime - përsëritje të ligjëratës paraprake, studentet do të njoftohen për procesin administrimit të procedurave tatimore dhe rendësin e kësaj qështjeje për ndërmarrësin dhe inovacionin, studentët do të njoftohen me rendësin e mbështetjes institucionale përmes strategjisë për inovacion dhe ndërmarrësi sipas ligjeve aktuale në fuqi, do të diskutohet me studente tema nga punimi shkencor, do të ketë diskutim grupor me studente për një rast ligjor të ngritur si qështje për trajtim. Rezultati i prituri nr. 4 dhe 7.
Java e pestë	Biznesi si korporatë dhe tatimi, Legjislacioni që e rregullon aktin e themelimit, Do të ketë ushtrim dhe diskutime për ligjëratën paraprake, studentët do të njoftohen rolin e korporatës për shoqërinë dhe tatimet që ju nënshtrohen, me aktin e themelimit të një biznesi (start-up), cilët janë dokumentet e nevojshme dhe ku realizohet regjistrimi, ARBK si institucion – ligji që e rregullon këtë fushë. Diskutime interaktive me studente për një problem të ngritur. Rezultati i prituri nr. 3 dhe 5.
Java e gjashtë	Konsumatori dhe ndërmarrësia, Parimet e aktivitetit ligjor në fushën e biznesore në vend, Në ligjëratë do të ketë përsëritje dhe shtjellim të materialit të përpunuar bashkërisht me studentet nga ligjëratat paraprake, studentet do të njoftohen me legjislacionin dhe rolin dhe rëndësinë e konsumatorit për ndërmarrjen, me sjelljen e konsumatorit dhe strategjitë e nevojshme për mbajtje të konsumatorit. Në vazhdim do të analizohen detyrat e studentëve – ata që i kanë afatet për prezantim do të realizojnë prezantimet. Diskutim me studentet për një problem ligjor të ngritur ndërlidhur me ligjëratën. Rezultati i prituri nr. 4.
Java e shtatë	Marrëdhënia detyrimore dhe biznesi, Masat anti-damping në import, Studentet do të njoftohen me rolin e marrëdhënies detyrimore për biznese, për masat anti-damping në import, çka është dumping, si vendosen masat anti-damping, në cilat raste dhe kush merr vendime,. Do të ketë diskutim me studentet për një problem ligjor të ngritur ndërlidhur me ligjëratën. Rezultati i prituri nr.6.
Java e tetë	Kontratat biznesore, Dispozitat ligjore ndërlidhur me biznesin në vende, Do të ketë përsëritje të materialit nga ligjëratat paraprake, studentet do të njoftohen me harmonizimin e akteve ligjore dhe me llojet e kontratave biznesore, me studentët do të ketë interaktivitet dhe do të ketë prezantim të punimeve të realizuara. Rezultati i prituri nr. 6.

Java e nëntë	Legjislacioni për Investimet e Huaja Direkte, Marrëdhënia e punës, Studentet do te njoftohen për rëndësinë e IHD për ekonomin e vendit, cili është roli i një biznesi stabile ne rritjen dhe zhvillimin ekonomik dhe tema qe ndërlidhen me rendësin e bashkëpunimit “Join-Venture” për investime. Studentet do te njoftohen me dispozitat ligjore qe e rregullojnë mardhënjën e punës, me dispozitat qe ndalojnë diskriminimin, krijimin e mardhenjes se punës përmes kontratës – te drejtat e punëtorit, statusin e tij ne shoqëri, studentët do te prezantojnë projekt hulumtimet nga fusha legjislativë dhe diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e dhjetë	Pronësia Intelektuale - Rëndësia për biznesin - inovacioni dhe ndërmarrësia, Ne këtë ligjëratë do te ketë përsëritje te materialit nga ligjëratat paraprake, studentet do te njoftohen me ligjin qe e rregullon pronësinë intelektuale ne vende – me markën tregtare, e drejta e autorit, patenta, etj, me rendësin e zbatimit te ligjit dhe ndikimin pozitiv te tij ne ekonomin me fokus ne inovacion dhe ndërmarrësi. Do te ketë diskutime grupore dhe studentët do te prezantojnë projekt hulumtimet nga fusha legjislativë dhe diskutime interaktive Rezultati i pritur nr. 4.
Java e njëmbëdhjetë	Tregu dhe PI ne BE, Ligji për Pronësi Intelektuale ne tregun e BE, Ne këtë ligjëratë studentet do te njoftohen me mënyrën e funksionimit dhe mbrojtjen ligjore te pronësisë intelektuale ne BE, me legjislacioni qe e rregullon fushën e tregut dhe elementet kryesore qe implementohen ne tregun e brendshëm te BE, pastaj do te ligjërohet për tregun e BE dhe si ndikon ai ne trendët ekonomike për vendet anëtare te BE, si është e rregulluar konkurrenca ne mes sektorëve publike dhe private ne tregun e BE, studentet do te prezantojnë punimet dhe do te ketë diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e dymbëdhjetë	Inteligjenca Artificiale dhe Legjislacioni ne BE Studentet do te njoftohen me legjislacion qe përdoret për Inteligjencën Artificiale ne BE, me legjislacioni qe e rregullon këtë fushë me rëndësi për mbrojtjen e te drejtave te privatësisë dhe rregullimin e përdorimit ne biznese. Studentet do te prezantojnë punimet dhe do te ketë diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e trembëdhjetë	Kontestet biznesore dhe zgjidhja jashtë -gjygsore, Legjislacioni për zgjidhje te kontesteve biznesore, Gjate ligjëratës do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me aktet juridike për zgjedhjen e kontesteve jashtë gjygsore biznesore, do te diskutohet për arbitrazhin, negociimin dhe ndërmjetësimin – dhe rëndësia e legjislacionit ndërlidhur me ndërmarrësinë dhe inovacionin, studentët do te prezantojnë projektet/punimet e tyre nga fusha e legjislacionit. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e katërbëdhjetë	Falimentimi, Ri-organizimi, Likuidimi, Dispozitat ligjore për falimentim te ndërmarrjeve,

	Ne ligjëratë do të ketë përsëritje të materialit të përpunuar nga mësimi paraprake, studentët do të njoftohen me ligjin për falimentim, ri-organizmi dhe likuidim të biznesit dhe rëndësia e tij për ndërmarrjet në vështërsi, kush janë institucionet vendimmarrëse, kush është administrator i falimentimit, çka është debitor në posedim, etj.. Diskutim interaktiv dhe prezantim të projekteve studentore. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e pesëmbëdhjetë	E Drejta e konkurrencës – rëndësia për ndërmarrësi dhe inovacion, Puna grupore, Studentët do të njoftohen me aktet normative që e rregullojnë të drejtën e konkurrencës, me institucionet mbikëqyrëse të konkurrencës në vend dhe rëndësinë për një ekonomi të drejte dhe pa monopol. Studentët do të prezantojnë punimet dhe do të ketë diskutime interaktive ndërlidhur me materialin e përdorur në ligjëratat për legjislacionin dhe biznesin. Rezultati i pritur nr. 8.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	